

## **Rezultatet e konsultimeve publike për projektligjin:**

### **“Për Shëndetin e Bimëve”**

#### **1. Titulli i draft aktit**

Projektligj “Për shëndetin e bimëve”

#### **2. Kohëzgjatja e konsultimeve**

Kohëzgjatja e përgjithshme e konsultimeve publike ka qenë nga data 26.7.2024 deri më 23.8.2024. Në këtë afat përfshihen takimet me grupet e interesit si dhe konsultimi përmes Regjistrit elektronik. Gjatë kësaj periudhe u realizua një takim në MBZHR, datë 21.10.2024 me grupet e interesit si: Shoqata AFADA, Shoqata e Prodhuesve, Shoqata e Fermerëve, Shoqata ADAD Malore, UBT Tiranë, si dhe disa operatorë kryesorë të prodhimit dhe tregtimit të bimëve dhe produkteve bimore, të cilët pas diskutimeve dhanë dakordësinë për përmbajtjen e projektligjit dhe nuk patën komente shtesë. Gjithashtu pati komunikime edhe përmes postës elektronike. Numri i shikimeve në RENJKP ishte 635 dhe nuk pati asnjë koment.

#### **3. Metoda e konsultimit**

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguroni informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë.

Përfshini gjithashtu aktivitetet nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Metodat e konsultimit të përdorura për projektligjin “Për shëndetin e bimëve”, ishin:

- konsultimi elektronik, përmes Regjistrit Elektronik, REKNJP, nga data 26.7.2024 deri në datën 23.8.2024;
- takim fizik në ambientet e MBZHR-së, njoftuar përmes postës elektronike, në datë 21.10.2024.
- komunikimi përmes postës elektronike.

#### **4. Palët e interesit të përfshira**

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit.

Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.

Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Palët e interesuara të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimin publik gjatë procesit të hartimit, janë:

- Z. Enver Isufi, Instituti i Bujqësisë Biologjike, organizatë anëtare e Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural, komunikim përmes postës elektronike;
- Shoqata AFADA, komunikim përmes postës elektronike dhe takim fizik;
- Shoqata e Prodhuesve, komunikim përmes postës elektronike dhe takim fizik;
- Shoqata e Fermerëve, komunikim përmes postës elektronike dhe takim fizik;
- Shoqata ADAD Malore, komunikim përmes postës elektronike dhe takim fizik;
- UBT Tiranë, komunikim përmes postës elektronike dhe takim fizik.

Projektligji u hartua nga një grup pune, I ngritur me urdhër të Ministrit nr.36, datë 24.1.2024, me një përfshirje të të gjithë institucioneve kontribuese: MBZHR, AKU, AKVMB dhe ISUV, MTM dhe UBT.

**5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/refuzuara**

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato; Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi

Zëvendësim termi	Termi “Për shëndetin e bimëve” të zëvendësohet me termin “Për Mbrojtjen e Shëndetit të Bimëve”	Z. Enver Isufi, Instituti i Bujqësisë Biologjike, organizatë anëtare e Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural	Nuk pranua	Për shëndetin e bimëve” është dakordësuar tashmë dhe gjithashtu edhe raportuar në raport progrese të dërguara me këtë titull. Gjithashtu është raportuar në bilateral në Bruksel dhe për këtë arsye nuk merret në konsideratë.
Shtim në fjali	Në nenin 1, në fjalinë “risqeve në një nivel të pranueshëm” të shtohet “risqeve në një nivel ekonomikisht të pranueshëm	Z. Enver Isufi, Instituti i Bujqësisë Biologjike, organizatë anëtare e Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural.	Nuk pranua	Nuk pranohet pasi kuptimi i fjales risk, ne kuptim te ketij ligji nenkupton nje aspekt me te gjere te riskut se ai ekonomik.
Përkufizim	Në nenin 3, pika 1 të jepet përkufizimi i termit “Autoritet kompetent” psh. 1/1Autoritet- Është fuqia ose e drejta që i jep ligji një personi ose institucioni për të marrë vendime në fushën përkatëse.	Z. Enver Isufi, Instituti i Bujqësisë Biologjike, organizatë anëtare e Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural.	Nuk pranua	Në nenin 3, pika 1 të jepet përkufizimi i termit “Autoritet kompetent”, <b>nuk merret ne konsiderate</b> , sepse perkufizimi i dhene eshte term juridik ndersa ne ligj, ky term i referohet struktures.

<p>Qartësi në përkufizim</p>	<p>Në nenin 3, pika 2 të jepet përkufizim më i qartë për termin “Bimë”-_një gjallesë botanike me pjesët e saj kryesore si rrënja si kërcelli/trungu,degët,gjethet, frutat,farëat.</p>	<p>Z. Enver Isufi, Instituti i Bujqësisë Biologjike, organizatë anëtare e Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural.</p>	<p>Nuk pranua</p>	<p>Në nenin 3, pika 2 të jepet përkufizim më i qartë për termin “Bimë”, <b>nuk merret ne konsiderat</b> sepse është sipas rregullores.</p>
<p>Shtesë në nenin 3 pika 3.</p>	<p>Në nenin 3, pika 3,të shtohet 3/1, termi “material mbjellës” dhe përkufizimi “Materiali mbjellës nënkupton bimët, pjesët e bimës si rrënjët, kërcelli, lastarët farëat, fidanat, tuberet, bulbat,të cilat përdoren për riprodhimin ,shtimin e bimëve për qëllime prodhimi, ose eksperimentimi”</p>	<p>Z. Enver Isufi, Instituti i Bujqësisë Biologjike, organizatë anëtare e Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural.</p>	<p>Nuk pranua</p>	<p>Në nenin 3, pika 3, të shtohet 3/1, termi “material mbjellës” (nuk u gjet në rregullore) dhe nuk dalim dot jashtë kontekstit. Vete termi bime i përfshihet te gjitha pavaresisht nga destinacioni i përdorimit.</p>
<p>Shtesë në fjali.</p>	<p>Në nenin 3, pika katër në fjalinë "Certifikata fitosanitare" është një dokument në letër ose elektronik i nënshkruar nga zyrtari certifikues për shëndetin e bimëve dhe që garanton përmbushjen e kushteve në lidhje me gjendjen shëndetësore të shtohet të bimëve ,ose materialit mbjellës të ngarkesë përkatëses, dhe i lëshuar në përputhje me kërkesat për shëndetin e bimëve të vendit të destinacionit;</p>	<p>Z. Enver Isufi, Instituti i Bujqësisë Biologjike, organizatë anëtare e Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural.</p>	<p>Nuk pranua</p>	<p>Nuk ka certifikatë vetëm për Materialin Mbjellës. Certifikatat janë vetëm për import, eksport, riekспорт. Certifikata fitosanitare i referohet bimes dhe jo destinacionit te bimes qe ne kete rast eshte material mbjelles.</p>

Shtesë në fjali.	Në nenin 3, pika 6 në fjalinë “Çrrënjosje” është zbatimi i masave fitosanitare për eliminimin e një dëmtuesi nga një zonë të shtohet “kuptohet menjanimi/largimi i një dëmtuesi nga një zonë e caktuar bujqësore ose jo bujqësore, me anë të zbatimit të masave komplekse fitosanitare.”	Z. Enver Isufi, Instituti i Bujqësisë Biologjike, organizatë anëtare e Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural.	Nuk u pranua.	Në nenin 3, pika 6 fjala “Çrrënjosje” është sipas rregullores. <b>Nuk e marrim në konsideratë.</b>
Shtim përkufizimi	Neni 3, pika 8 të shtohet “Dëmtues” përfshin grupin e parazitëve me origjinë siç është kërpudha, bakteri, virusi...	Z. Enver Isufi, Instituti i Bujqësisë Biologjike, organizatë anëtare e Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural.	Nuk u pranua	Eshte sipas përkufizimit ne ISPM.
Shtim përkufizimi	Në nenin 3, pika 11 të shtohet 11/1.Incidencë dhe përkufizimi “Numri i bimëve,ose organeve të bimës të prekura në një mostër bimësh ose organesh të analizuar,për të përcaktuar nivelin e infeksionit), si dhe të jepen dhe shpjegohen termat: “Infestim” kur bimët preken nga parazitët me origjinë mikroorganizmat (kërpudha, bakterie viruese dhe te ngjashme me to)	Z. Enver Isufi, Instituti i Bujqësisë Biologjike, organizatë anëtare e Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural.	Nuk u pranua.	“Incidencë” është në rregullore dhe është marr përkufizimi në rregullore por fjala incidencë në draft është lënë “ndodhi” si një fjalë e përshtatshme në gjuhën shqipe. Nuk u mor ne konsideratë. Termi “Infestim” nuk është në rregullore.as në draft. <b>Nuk merit në konsideratë.</b> Termi “Inketim” nuk eshte as ne

	“Inketim” kur bimët preken nga insektet dhe të ngjashme me to			draft as në rregullore. <b>Nuk merret në konsideratë</b>
Shtesë në fjali	Në nenin 3, pika 12 të shtohet nuk ka qenë ende i pranishëm ose ka qenë i pranishëm ,por tani është vërtetuar prania e tij, ose është...	Z. Enver Isufi, Instituti i Bujqësisë Biologjike, organizatë anëtare e Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural.	Nuk u pranua	Në nenin 3, pika 12 të shtohet “nuk ka qenë ende i pranishëm” nuk është në rregullore. Nuk merret në konsiderate.
Zëvendësim	Në nenin 3, pika 15 fjala “ekzaminim” të zëvendësohet me vendoset kontrolli fitosanitarë i bimëve	Z. Enver Isufi, Instituti i Bujqësisë Biologjike, organizatë anëtare e Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural.	Nuk u pranua.	Në nenin 3, pika 15 fjala “ekzaminim” do të zëvendësohet me termin “kontrolli fitosanitarë i bimëve”. Ekzaminimi (vetëm kur bën analiza). Neni perkates ne projekt ligj eshte: 13. “Testim” është një ekzaminim zyrtar, i ndryshëm nga ai vizual, për të identifikuar dëmtuesit ose për të përcaktuar nëse dëmtuesit janë të pranishëm; eshte e shprehur mire dhe eshte gjithepershiresë, pasi testimet mund te jene te ndryshme dhe gjithahtu fjala ‘

				ekzaminim” është me kuptim të gjere, por në perkufizim është cituar “ekzaminim zyrtar, i ndryshëm nga ai vizual”.
Shtesë në fjali.	Në nenin 3, pika 17 në fjalinë “Kodi i gjurmueshmërisë është një kod me shkronja, numra ose të përzier me shkronja e numra që identifikon” të shtohet “ dhe personalizon identitetin e një ngarkesë, lot ose...”	Z. Enver Isufi, Instituti i Bujqësisë Biologjike, organizatë anëtare e Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural.	Nuk u pranua.	-Në nenin 3, pika 17 në fjalinë “Kodi i gjurmueshmërisë” .Është marrë sipas rregullores. <b>Nuk merret në konsiderat.</b>
Shtim perkufizimesh	Në nenin 3, pika 19 të shtohen 19/1. “Karantinë” është praktika ,e cila mënjanon futjen në një teritor të një dëmtuesi, sëmundje ose bari të egër me rreziksmëri të lartë për vendin ose zonën përkatëse. 19/2. “Izolim” quhet masa , e cila izolon në vende të sigurta për një kohë të caktuar, bimë, produkte bimore, ose material mbjellës me infeksione nga dëmtues, sëmundjet ose barërat e egra të shpallura si objekte karantinore, deri sa mbi këto materiale të zbatohen masat parandaluese për përhapjen e mundëshme të tyre në mjedisin bujqësor.	Z. Enver Isufi, Instituti i Bujqësisë Biologjike, organizatë anëtare e Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural.	Nuk u pranua.	Në nenin 3, pika 19, të shtohen 19/1 “Karantinë”. Në aktualisht kemi termin “stacion karantinor”. Në rregullore nuk është “karantinë” por “stacion karantinor”. <b>Nuk merret në konsiderat.</b> Termi 19/2 “izolim” nuk është në rregullore. Në rregullore është termi “Objekt izolimi” për të cilin është në draftligj dhe për këtë arsye nuk merret në konsideratë.

Zëvendësim fjale	Në nenin 3, pika 20, “Masa fitosanitare” të bëhet “Masa fitosanitare karantinore”	Z. Enver Isufi, Instituti i Bujqësisë Biologjike, organizatë anëtare e Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural.	Nuk pranua	-Në nenin 3, pika 20, “Masa fitosanitare” të bëhet “Masa fitosanitare karantinore” është sipas rregullores.
Zëvendësim fjale	Në nenin 3, pika 21, “zbatimi i masave fitosanitare” të zëvendësohet me “Zbatimi i masave mbrojtëse fitosanitare”	Z. Enver Isufi, Instituti i Bujqësisë Biologjike, organizatë anëtare e Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural.	Nuk pranua	Në nenin 3, pika 21, “zbatimi i masave fitosanitare” të zëvendësohet me “Zbatimi i masave mbrojtëse fitosanitare”. <b>Kjo nuk ka pse të shtohet,</b> sepse është vazhdimi i pikes 20.
Shtim përkufizimesh	Në vijim të shtohen termat dhe përkufizimet e mëposhtme: <b>“Kontrolli fitosanitar”</b> është vizita që u bëhet bimëve dhe çdo lloji material i bimor bazuar në metodikat e miratuara, për të parë nëse është e prekur nga ndonjë parazit dhe në çfarë shkalle është prekur. <b>“Monitorimi fitosanitar”</b> është analiza e të dhënave të mara herëpashere në terren ose laborator për të parë ecurinë e rezultareve të kontroleve të bëra, për të gjykuar mbi dinamikën e gjendjes fitosanitare.	Z. Enver Isufi, Instituti i Bujqësisë Biologjike, organizatë anëtare e Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural.	Nuk pranua	Termi “Kontrolli fitosanitar”. Mund të qëndrojë si përkufizim dhe do shikohet për tu marrë në konsideratë të ligji i Kontroleve Zyrtare. <b>Nuk do merret në konsideratë.</b> Termi “Monitorimi fitosanitar” edhe ky term ska pse të shtohet. Mund të qëndrojë si përkufizim dhe do shikohet për tu marrë në konsideratë të ligji i



	(Psh.të matja e tensionit të gjaku është kontroll.Të analizosh se si kanë ecur shifrat per 5-10 matje është monitorim.Ose,të regjistrosht fluturat ne feromon eshte kontroll, të analizosh se si ka ecur fluturimi per kete muaj ose vit është monitorim. Pra monitorimi te con ne nje perfundim me te madh).			Kontrolleve Zyrtare. <b>Nuk do meret në konsideratë.</b>
Sqarim termi	<p><b>Sqarim: Termi Kontroll dhe termi “Mbrojtje”</b></p> <p>Kohët e fundit po përdorim termin psh. “Kotrolli i ullirit nga miza”. Ky term është gabim. Duhet të përdoret ”Mbrojtja e ullirit nga miza”.</p> <p>Studentëve tanë u flitet e shkruhet me termat: kontrolli biologjik, kontrolli kimik etj. Duhet përdorur termi “mbrojtje”. Ne nuk kemi “Departament te Kontrollit të Bimëve”, por Departamenti i Mbrojtjes së Bimëve (Plant Protection Department).</p> <p>Këtu ndoshta duhet përkufizaur termi “Mbrojtja e Bimëve”</p> <p><b>“Mbrojtja e bimëve”</b> nënkupton tërësinë e masave mbrojtëse ndaj parazitëve të bimëve , deri në ato kufinj që dëmi i tyre ekonomik është nën koston e mbrojtjes”.</p>	Z. Enver Isufi, Instituti i Bujqësisë Biologjike, organizatë anëtare e Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural.	Nuk u pranua	Termi “Kontroll ” dhe termi “Mbrojtje” Draft ligji e ka te qarte ne permbajtje te tij pasi me termin kontroll i referohet kontrollit te demtuesve, ndersa me termin mbrojtje i referohet mbrojtjes se bimeve nga demtuesit.
Shtesë në përkufizim	Në nenin 3, pika 25. Në përkufizimin e termit Monitorim të shtohet “Monitorimi është kontrolli i	Z. Enver Isufi, Instituti i Bujqësisë Biologjike,	Nuk u pranua	Në nenin 3, pika 25 termi “Monitorim” është sipas rregullores.

	bimëve bazuar në metodikat e miratuara, në të gjitha mjediset ku ato janë mbjellë, ose ruajtur produktet bimore, për të përcaktuar gjendjen e tyre fitosanitare nga prekjet nga parazitët e ndryshëm.”	organizatë anëtare e Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural.		
Shtesë në përkufizim	Në nenin 3, pika 26 në përkufizim të shtohet “tjera nga është marrë, bazuar në metodikat e miratuara për analizim...”	Z. Enver Isufi, Instituti i Bujqësisë Biologjike, organizatë anëtare e Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural.	Nuk pranua	Në nenin 3, pika 26 në përkufizim të shtohet “tjera nga është marrë. Nuk merret në konsideratë, pasi të gjitha mostrat merren dhe analizohen sipas metodikave perkatëse të miratuara me akte ministri.
Shtesë në nenin 3.	Në nenin 3, pika 34, C të shtohet pika C/1 Zbatimin e praktikave për mbrojtjen e bimëve nga parazitët	Z. Enver Isufi, Instituti i Bujqësisë Biologjike, organizatë anëtare e Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural.	Nuk pranua	Në nenin 3, pika 34, C të shtohet pika C/1. është sipas rregullores. <b>Nuk merret në konsideratë.</b>
Shtesë në nenin 3.	Në nenin 3, pika 40 të shtohet <b>40/1. Zonë e lirë ndaj paraziëve të bimëve</b>	Z. Enver Isufi, Instituti i	Nuk pranua	Në nenin 3, pika 40 të shtohet 40/1. Të shtohet një

	<p>që nënkupton se në zonën nën monitorim paraziti (inseki, sëmundja barë i egër në fjalë) nuk është fare i pranishëm . Pra është (Free zone) Free from X Y, paraziti)</p>	<p>Bujqësisë Biologjike, organizatë anëtare e Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural.</p>		<p>përkufizim tjetër “zone e lire ndaj parazitëve te bimeve”, nuk merret ne konsiderat pasi nuk është ne përkufizimin e rregullores, për rrjedhojë edhe ne brendesi te draftligjit. Nëse do dal si term ne aktet nenligjore ne zbatim te ketij ligji, do merret ne konsiderat kur te hartohet drafti.</p>
<p>Shtesë në përkufizim.</p>	<p>Në nenin 3, pika 40 në përkufizim duhet të përfshihet “Është një pikë kontrolli zyrtar me mjete dhe ekspertë për kontrollin e bimëve, produkteve bimore dhe materialit mbjellës për të menjanuar futjen e parazitëve karantinorë që ndodhen në listën zyrtare kombëtare)”</p>	<p>Z. Enver Isufi, Instituti i Bujqësisë Biologjike, organizatë anëtare e Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural.</p>	<p>Nuk u pranua</p>	<p>Kjo nuk merret ne konsideratë, pasi kjo pike i referohet planit te kontrollit dhe jo pikes se kontrollit sic propozohet.</p>
<p>Shtesë në nenin 3.</p>	<p>Në nenin 3 pika 44 të shtohet "Shëndeti i bimëve" ose “Fitosaniteti” dhe të riformulohet i gjithë përkufizimi, sepse nuk është shumë i qartë dhe të shtohet</p>	<p>Z. Enver Isufi, Instituti i Bujqësisë Biologjike, organizatë anëtare e</p>	<p>Nuk u pranua</p>	<p>Në nenin 3 pika 44 të shtohet "Shëndeti i bimëve" ose “Fitosaniteti”. Është sipas rregullores.</p>

	43/1 “Shërbimi i mbrojtjes së bimëve”	Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural.		
Në lidhje me qartësinë e nenit.	Në nenin 3 pika 49 nuk është e qartë dhe lehtësisht e kuptueshme.	Z. Enver Isufi, Instituti i Bujqësisë Biologjike, organizatë anëtare e Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural.	Nuk u pranua	Termi vrojtim është marr nga perkufizimet e ISPM.
Të shtohen pika në nenin 3.	Në nenin 3 , pika 50 të shtohen: <b>50/1.Shërbimi i Mbrojtjes së Bimëve</b> nënkuptojmë tërësinë infrastrukturës së përbërë nga institucionet drejtuese, zbatuese, shkencore, rrjetin e bazës materiale dhe logjistikës ,publike dhe private ,si dhe ekspertizën profesionale publike dhe private. <b>50/2.Bimë e shëndetëshme</b> është ajo bimë e cila nuk vuan nga ana fiziologjike nga ndonjë parazit i dukshëm ose i padukshëm dhe nuk shfaq ndonjë shënjë vuajtje,dhe ka rritje dhe prodhim normal. <b>50/3. Bimë e sëmurë</b> është ajo bimë që shendetit i saj fiziologjik vuan nga një ose disa parazitë,të dushkëshëm ose jo, vuan nga kushtet e pa përshtaëshme të tokës ose mjedisit klimatk.Këtë e shpreh më shëndet dhe	Z. Enver Isufi, Instituti i Bujqësisë Biologjike, organizatë anëtare e Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural.	Nuk u pranua	Në nenin 3 , pika 50 të shtohen termat nga 50/1 deri 50/7. Te gjitha pikat nuk do meret në konsideratë. Pika <b>50/1</b> i referohet mbrojtjes se bimeve dhe jo shendetit te bimeve qe eshte objekt i ketij ligji.  Per pikat <b>50/2</b> dhe <b>50/6</b> citojne termate cilat nuk jene ne permbajtje te rregullores dhe te draftligjit.  Pika <b>50/7</b> , logoja e mbrojtjes se bimeve nuk mund te citohet ne draftin e shendetit te bimeve pasi mbrojtja e bimeve

	<p>prodhim nën kapacitein esaj prodhues.</p> <p><b>50/4 Mbrojtje paraprake e shëndetit të bimëve</b> kuptojmë tërësinë e masve agronomike, të cilat shmangin ose kufizojnë nivelin e infeksionit potencial nga parazitët dhe barërat e egra.</p> <p><b>50/5.Prognozimi në mbrojtjen e bimëve</b> kuptojmë tërësinë e përvojave shkencore në parashikimin e infeksionit potencial nga një parazit i dhënë në një zonë të dhënë klimatike</p> <p><b>50/6 Lajmërim</b> kuptojmë mesazhet që u shpërndahen prodhuesëve të produkteve bujqësore mbi rrezikun e mundëshëm të një paraziti të dhënë në një kohë të dhënë e në një zonë klimatike dhënë.</p> <p><b>50/7. Logo Kombëtare e Shëbimit të Mbrojtjes së Shëndetit të Bimëve</b> (Mendoj se duhet të përshkruhet kjo logo sipas rregullave për përshkrimin e logove, sepse ajo ka edhe tregues sekreti njëkohësisht)</p>			<p>është me e madhe se ajo e shëndetit të bimeve.</p>
Ndryshim titulli	<p>Në titullin e Kreut II, “SHËRBIMIT TË SHËNDETIT TË BIMËVE” të bëhet “SHËRBIMIT TË MBROJTJES SË SHËNDETIT TË BIMËVE”</p>	<p>Z. Enver Isufi, Instituti i Bujqësisë Biologjike, organizatë anëtare e Rrjetit Shqiptar për</p>	<p>Nuk u pranua</p>	<p>Në titullin e Kreut II, “SHËRBIMIT TË SHËNDETIT TË BIMËVE” të bëhet “SHËRBIMIT MBROJTJES SË SHËNDETIT TË BIMËVE” <b>Nuk merret në konsiderat</b> pasi i</p>

		Zhvillimin Rural.		referohet rregullores perkatese te BE-se qe eshte per shendetin e bimeve.
Zëvendësim fjale.	Në Kreun II, neni 16 të shtohet “Dëmtuesit Prioritarë (Parësor)”	Z. Enver Isufi, Instituti i Bujqësisë Biologjike, organizatë anëtare e Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural.	Nuk u pranua	Në Kreun II, neni 16 të shtohet “parësor” “Dëmtuesit Prioritarë (Parësor)”. Nuk merret ne konsiderat pasi prish llogjikën e klasifikimit të demtuesve.
Sugjerim mbi organigramën	Sugjerohet krijimi i një organigrame si vijon.  Organigrama e organizimit të Mbrojtjes së Shëndetit të Bimëve, kërkuar nga ligji i ri (2024)	Z. Enver Isufi, Instituti i Bujqësisë Biologjike, organizatë anëtare e Rrjetit Shqiptar.	Nuk u pranua	Ligji nuk mund të parashikojë organigramë po vetëm institucionet e varësisë që janë parashikuar në nenet 5 dhe 6 të projektligjit.